KËRKESË
Nr. 3220, datë 6.4.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rikonstruksioni i rrugës 'Ago Çeli' dhe Rrugës së Re, si dhe rikonceptimi i palestrës së lagjes 15 Shtatori, Tepelenë".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tepelenë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", dhe në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 14,260,649.10 (katërmbëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e nëntë pikë dhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Etjen Xhafaj

Lista paraprake e shpronësimit të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugës 'Ago Çeli' dhe Rrugës së Re , si dhe rikonceptimi i palestrës së lagjes 15 Shtatori"

	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m^2)	Shpronësime toke "truall"			Ndërtesë jobanimi		Ndërtesë banimi			Vlera totale	Shënimet në kartelën e pasurisë
								Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sip. nd. konf. nga. ZVRPP (m^2)	Vlera sipas preventivit (lekë)	Sip. nd. konf. nga. ZVRPP (m^2)	Çmimi sipas EKB-së (lekë)	Vlera sipas EKB-së (lekë)		
1	Valentina	Ismail	Muska	3574	14/300	Truall + ndërtesë	60	60	1,015.00	60,900.00	97	2,246,354.00	0	0	0	2,307,254.00	Objekt 2k., seksioni D. 27.4.2014, mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. Pasurie 30/60- nd., vol. 8. faqe 116, seksioni E 14.5.2002, lirohet pasuria nga bllokimi në favor të bankës së kursimeve sh.a., 27.5.2002 bllokohet pasuria në favor të Fondacionit Besa për shumën 300000 lekë, 18.10.2010 bllokohet pasuria në favor të Fondacionit Besa sh.a., 27.4.2014 ndalohen veprimet mbi pasurinë 4.7.20174 lirim hipoteke.
2	Natasha Gazmend Klodian Marsel	Alem Zaho Zaho Zaho	Balili Balili Balili Balili	3574	16/220	Truall + ndërtesë	32	32	1,015.00	32,480.00	32	1,112,798.00	0	0	0	1,145,278.00	Seksioni D, nuk ka shënime në kartelë; seksioni E, 9.6.2017, në bazë të urdhrit të regjistruesit hiqet masa e kufizimit mbi pasurinë.
3	Maksim	Nasip	Sala	3574	14/307	Ndërtesë	50	0	0	0	50	2,035,262.00	0	0	0	2,035,262.00	Seksioni D, 27.4.2014, ndërtesa ndodhet mbi truallin me nr. pasurie. 14/307, vol. 15, faqe. 32; seksioni E, në bazë të urdhrit të regjistruesit hiqet masa e kufizimit mbi pasurinë.
4	Iliaz	Çobo	Qorri	3574	16/97	Truall + ndërtesë	78	30.9	1,015.00	31,363.50			156	28,320.60	4,418,013.60	4,449,377.10	Objekt 2k, seksioni D, nuk ka shënime në kartelë; seksioni E, 8.7.2016, ndalohen veprimet mbi pasurinë.
5	Aristidh	Sani	Rushiti	3574	16/308	Truall	405	30	1,015.00	30,450.00	0	0	0	0	0.0	30,450.00	Seksioni D, Nuk ka shënime në kartelë; seksioni E, 6.7.2016, ndalohen veprimet mbi pasurinë.
6	Sherif	Çobo	Selimi	3574	14/281	Truall + ndërtesë	50	50	1,015.00	50,750.00	50	1,709,792.00	0	0	0	1,760,542.00	Seksioni D, nuk ka shënime në kartelë; seksioni E, nuk ka shënime në kartelë.
7	Edlira Emblika Ilirjan Manjola Edlira	Muha Myftar Xhemo Xhemo Xhemo	Jovani Muha Muha Muha Muha	3574	14/14	Truall + ndërtesë	30	30	1,015.00	30,450.00	21.2	939,889.00	0	0	0	970,339.00	Seksioni D, nuk ka shënime në kartelë; seksioni E, nuk ka shënime në kartelë.
8	Votim	Xhemal	Asllani	3574	16/309	Truall	393	28.5	1,015.00	28,927.50	0	0	0	0	0	28,927.00	Seksioni D, nuk ka shënime në kartelë; seksioni E, 14.11.2016, bllokohet pasuria në favor të Bankës Popullore për shumën 1800000 lekë, 8.7.2016, bllokohet pasuria në favor të kreditorit Mane Rushiti, për shumën 2700000 lekë, 8.7.2016, mbi këtë pasuri ka ndërtim pa leje 6.7.2016, ndalohen veprimet mbi pasurinë.
9	Pajtim	Lutfi	Ruçi	3574	16/178	Truall + ndërtesë	25	25	1,015.00	265,321.00	25	1,507,845.00	0	0	0	1,533,220	Seksioni D, nuk ka shënime në kartelë; seksioni E, nuk ka shënime në kartelë.
Vlera totale e shpronësimit																**14,260,649.10**	

Shënim.

1. Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazur në Vkm-në nr. 89, datë 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

2. Vlerësimi i objektit “ndërtesë banimi dhe jo banimi” është bërë në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të këshillit ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.